

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MI-TO” SHPK**

Sot, më datë **26.09.2023**, u paraqiten personalisht:

- **Z. Kleantino Goga**, i datëlindjes 05/08/1992, shtetas shqiptar, lindur në Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J20805084K.
- **Znj. Elona Beli**, e datëlindjes 22/12/1975, shtetase shqiptare, lindur në Durrës, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. H56222129C.

Të cilët përpiluan këtë akt -themelimi të shoqërisë tregtare **“MI-TO”** shpk, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare **“MI-TO”** shpk, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht me emrin **“MI-TO”** shpk, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin e shoqërisë.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**


**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin e subjektit **“MI-TO”** shpk dhe me emrin tregtar **“MI-TO”** shpk. Ajo do të ketë edhe vulën e saj sipas legjislacionit në fuqi.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

- Bar Kafe, Coctail Bar, bistro, Snack Bar, lokal nate me aktivitet 24h, lounge.
- Organizim dhe menaxhim eventesh artistike dhe evente televizive.
- Import-eksport materialesh e artikujsh për krijimin e koktaileve si dhe për zhvillimin e aktivitetit të mësipërm.
- Shërbime bar, kafe, katering, klub nate, diskotekë me shërbime të ushqimit social, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të bari i lokalit, konsulencë, reklamim dhe veprimtari reklamuese si dhe shërbime të tjera të lidhura më sa më sipër.
- Administrimin dhe shfrytëzimin e bareve, restoranteve, klubeve të natës si dhe çdo mjedis tjetër në të cilin ofrohen pije alkoolike dhe joalkoolike si dhe ushqime.



## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Shoqëria “MI-TO” shpk do ta ketë selinë në Tiranë, Shqipëri me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Ismail Qemali”, Pallati 11, Shk 3, Hyrja 21, Kati i parë, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është **500 000 (pesëqind mijë)** lekë dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar është: **500 000 (pesëqind mijë)**

Vlera e paguar: **500 000 (pesëqind mijë)**

Numri total i kuotave: 2 (dy).

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

## NENI 7

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare “MI-TO” zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues: **Z. Kleantino Goga**

Vlera e Kapitalit në lek **200 000 lekë**

Numri i kuotave : **1**

Pjesëmarrja në përqindje (%) **40**

Ortaku themelues: **Znj. Elona Beli**

Vlera e Kapitalit në lek **300 000 lekë**

Numri i kuotave : **1**

Pjesëmarrja në përqindje (%) **60**

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shumë do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare.

Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në Statut.

## NENI 8

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 9

### Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve i cili zgjidhen për një mandat 5 (pesë) - vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë:

- **Z. Kleantino Goga**, i datëlindjes 05/08/1992, shtetas shqiptar, lindur në Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J20805084K.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## NENI 12

Mosmarrvëshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.


## NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe.

## ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

### MI-TO SHPK

**ELONA BELI**



**KLEANTINO GOGA**

